



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:200210
Datë: 04.11.2024
Numri i dokumentit: 06393737

Pml.nr.634/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar i kolegjit, Afrim Shala dhe Rasim Rasimi, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, si procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarit F.D., nga P., për shkak të veprave penale: “Lëndimi i lehtë trupor”, nga neni 185, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1, nën-paragrafi 1.4. të Kodit Penal të Republikës të Kosovës (KPRK) dhe “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366, paragrafi 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.295/2019, të datës 21.05.2024 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr.424/2024, të datës 12.09.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 30.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit F. D., e paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.295/2019, të datës 21.05.2024 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.424/2024, të datës 12.09.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.295/2019, të datës 21.05.2024, i dënuari F. D., është shpallur fajtor për shkak të veprave penale: “Lëndimi i lehtë trupor”, nga neni 185, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1,

nën-paragrafi 1.4. të KPRK-së (pika I. e dispozitivit) dhe veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366, paragrafi 1 të KPRK-së (pika II. e dispozitivit), ashtu që ndaj të njëjtit, për shkak të veprës penale sipas pikës I. të dispozitivit është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) vit e gjashtë (6) muaj, në të cilin dënim do t’i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe në arrest shtëpiak, nga data 10.09.2019 deri më datën 06.02.2020, kurse për shkak të veprës penale sipas pikës II. të dispozitivit është shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej njëmijë (1.000) euro, të cilat dënime do të ekzekutohen në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Nëse i dënuari nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, ashtu që për çdo njëzetë (20) euro të papaguar do të llogaritet një (1) ditë burgim.

Ndaj të dënuarit F. D., është konfiskuar arma e markës “Crvena Zastava” e kalibrit 7,65 mm, modeli 70, me numër serik C-..., si mjet i kryerjes së veprës penale, ashtu që është urdhëruar Policia e Kosovës, që pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë dhe verifikimit, të bëjë asgjësimin e kësaj arme.

Është detyruar i dënuari F. D., që t’i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë: në emër të paushallit gjyqësor shumë prej pesëdhjetë (50) euro, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej pesëdhjetë (50) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Të dëmtuarit: E. S., B. S. dhe O. S., për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil.

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin e PAKR.nr.424/2024, e datës 12.09.2024, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur:

- mbrojtësi i të dënuarit, avokati Ramiz Krasniqi, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës penale, shkeljeve të ligjit penal dhe vendimit për dënimin, duke i propozuar Gjykatës Supreme të Kosovës që kërkesën ta aprovon, ndërsa aktgjykimet e kundërshtuara t’i ndryshon, ashtu që ndaj të dënuarit të shqipton dënim më të butë.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.365/2024, e datës 21.10.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), si dhe pasi i vlerësoi pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe përgjigjen në kërkesë të Kryeprokurorit të Shtetit, gjeti se:

- kërkesa është e pabazuar.

Mbrojtësi i të dënuarit, në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.10. dhe paragrafi 2, nën-paragrafët 2.6. dhe 2.7. të KPP-së, për shkak se dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është i pakuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij, në të nuk janë paraqitur arsyet lidhur me faktet vendimtare, ka kundërthënie të konsiderueshme ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetim dhe po ashtu si i tillë, aktgjykimi në fjalë nuk është përpiluar konform me dispozitën e nenit 369 të KPP-së.

Gjithashtu, edhe me shqiptimin e dënimit me burgim për veprën penale nga pika I. e dispozitivit të aktgjykimit, gjykatat e kanë shkelur ligjin penal në dëm të të dënuarit, pasi që sipas mbrojtësit, dispozita e nenit 185 ... pika 1.4. të KPRK-së ka përcaktuar dënim me gjobë ose dënim me burgim, andaj edhe ndaj të dënuarit pa të drejtë është shqiptuar dënim me burgim, në vend se të shqiptohet dënim me gjobë.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shikimit të shkresave të lëndës konstatoi se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pabazuar, për faktin se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë nuk janë të përfshira me ndonjë shkelje të esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe as me shkelje të ligjit penal në dëm të të dënuarit Fatlum Dibrani.

Mbrojtësi i të dënuarit në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë nuk ka specifikuar konkretisht se ku qëndrojnë shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.10. dhe paragrafi 2, nën-paragrafët 2.6. dhe 2.7. të KPP-së, përveç se i përmend si të tilla. Sidoqoftë, Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka vërejtur që aktgjykimet e kundërshtuara të jenë përfshirë me shkelje të këtyre dispozitave të procedurës penale, pasi që dispozitivi i aktgjykimeve në fjalë është i qartë, nuk është kundërthënës, ndërsa në arsyetimet e tyre janë paraqitur arsye të mjaftueshme për të gjitha pikat, përkatësisht çështjet e rëndësishme, andaj edhe si të tilla, këto aktgjykime rezultojnë se janë përpiluar konform dispozitës përkatëse ligjore nga neni 369 të KPP-së.

Gjykata Supreme e Kosovës e konsideron të pabazuar edhe pretendimin e mbrojtësit të të dënuarit në lidhje me shkeljen e ligjit penal, pasi që gjykatat e instancave më të ulëta nuk kanë tejkaluar kompetencat e tyre ligjore me rastin e shqiptimit të dënimit me burgim për veprën penale “Lëndimi i lehtë trupor”, nga neni 185, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1, nën-paragrafi 1.4. të KPRK-së, pasi që për këtë vepër penale është parashikuar dënim me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet, ndërsa ndaj të dënuarit, siç është theksuar edhe më lart është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) vit e gjashtë (6) muaj, çka do të thotë se dënimi është shqiptuar në kuadër të kornizave ligjore, përkatësisht në kuadër të minimumit dhe maksimumit të dënimit të parashikuar për këtë vepër penale.

Në fund, duhet theksuar se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është paraqitur edhe sa i përket vendimit lidhur me dënimin, mirëpo bazuar në nenin 432 të KPP-së nuk është e lejuar që të paraqitet ky mjet juridik për shkak të vendimit lidhur me dënimin.

Përndryshe, edhe në këtë çështje penale, Gjykata Supreme e Kosovës rithekson se matja e dënimeve dhe vlerësimi i rrethanave përkatëse relevante është në kompetencë të gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë, varësisht nga rrethanat e rastit, ndërsa duke u bazuar në nenin 432, paragrafi 1 të KPP-së, këto pretendime në lidhje me shqiptimin e dënimeve më të buta, nuk mund të jetë arsye për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.

Andaj, edhe nga arsyet e cekura më lart, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pabazuar dhe pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
Pml.nr.634/2024, më datë 30.10.2024

Procesmbajtës,
Bujar Balaj

Kryetar i kolegjit,
Agim Maliqi